



Familja  
Consilex

Tipologjia  
Tretësira silani ose siloksani me bazë tretës

Linjat e produkteve  
• Aqua  
• Building

Kategoritë e përdorimit  
• Hidroizolim i tejdukshëm i tarracave dhe ballkove me pllaka  
• Trajtime kundër ujit për suvara dhe muratura

Përbërësit  
Monokomponent

Paraqitja  
I lëngshëm

CSX.0095

## PROTECH BALCONY

Hidroizolues i tejdukshëm, jo filmik, për tarraca dhe ballkone

### Kodi doganor

3824 9970

### Amballazhimi

- Bidon 5 l
- Shishe 1 l
- Bidon 2 l
- Kutë: 12 x (Shishe 1 l)
- Kutë: 8 x (Bidon 2 l)

### Aplikimi

- Furçë e madhe
- Mallë sfungjer
- Ngopje
- Brushë
- Sfungjer

## Përshkrimi i produktit

Tretësirë me bazë tretës rrëshire të veçantë silani dhe siloksani, shumë depërtuese, e tejdukshme (pa ngjyrë), për të hidroizoluar me shpejtësi, e në mënyrë efikase dhe ekonomike ballkone, tarraca të mbuluara me pllaka, mbulim betoni, shkallë të jashtme etj. pa hequr ose ndërhyrë në dyshemenë. Nuk e ndryshon pamjen e shtresës mbështetëse mbi të cilën aplikohet dhe nuk e ndryshon rrëshqitshmërinë origjinale ose avullimin nga uji. Aplikohet në një kohë shumë të shkurtër, nuk kërkon punë të kualifikuar ose pajisje profesionale. Dyshemeja e trajtuar do të jetë e përdorshme menjëherë pas 2 orësh nga hedhja.

## Të dhëna shtesë

PROTECH BALCONY është një produkt i lehtë dhe i shpejtë për t'u përdorur: thjesht përhapeni atë me një furçë të madhe në sipërfaqe të pastra dhe të thata për të zgjidhur problemin e depërtimit të ujit. Përbërësi aktiv, që transmetohet në mënyrë të efektshme në një tretës, depërton me shpejtësi dhe në thellësi të çarjeve, në vrimat e mundshme dhe në porozitetin e shtresës mbajtëse. Me kontaktin me ajrin, kryen një reaksion polimerizues që vulos dhe hidroizolon në mënyrë perfekte dhe në thellësi, të gjitha plasaritjet ku arrin të depërtojë. Pas reaksionit, molekula specifike siloksane polimerizuese bëhet e qëndrueshme me kalimin e kohës dhe nuk lëviz. Kështu, jeta efektive e produktit që aplikohet në sipërfaqe të cilat nuk pësojnë lëvizje dinamike dhe aktivitetit sizmik, zakonisht është më i gjatë se 10 vjet.. Nëse lind nevoja, nëse pas aplikimit të parë të PROTECH BALCONY shfaqen shkëputje, çarje, plasaritje, krepja, etj, këto mund të zgjidhen me një aplikim të dytë të produktit.

Duke pasur parasysh natyrën e tij jo filmike, produkti nuk mund të pësojë hapje, plasaritje, ndarje, shkëputje, përkeqësim dhe nuk do të zverdhet me kalimin e kohës, nën efektet e rrezet UV (siç ndodh natyrshëm për trajtimet epokside dhe / ose poliuretani).

Sipërfaqja e trajtuar me PROTECH BALCONY do të jetë rezistente ndaj mykut, myshqeve, likeneve dhe trupave të tjera biodeteriogenikë.

Vlen të theksohet se hidroizolimi dhe papërshkueshmëria e PROTECH BALCONY është vërtetuar me prova laboratorike të departamentit të inxhinierisë strukturore të POLITEKNIKUT TE MILANOS.

## Konsumi

Përafërsisht 0.15 litra PROTECH BALCONY për çdo metër katror të sipërfaqes që do të trajtohet, bazuar në porozitetin e mbështetjes.

## Fushat e përdorimit

Hidroizolim i shpejtë i ballkoneve, tarracave, verandave, shkallëve, sipërfaqeve me pllaka, shtrimeve prej betoni dhe guri natyror, pa prishjen e dyshemeve ekzistuese. Gjithashtu mund të përdoret edhe në sipërfaqe vertikale veçanërisht të ekspozuara ndaj erozioneve dhe agjentëve atmosferikë (mure të veshura, të suvatuara, me tulla balllore, etj.).



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: 25/08/2020  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në [www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

## Vetitë kryesore



Produkt në dukje



Jetëgjatësia:  
6 muaj



Material i ndezshëm



Pesha specifike:  
0.85 kg/l



Produkt me bazë tretës



Rezistent ndaj rrezeve UV



Të përdoret me doreza mbrojtëse



Temperatura e aplikimit:  
+5 / +30 °C



Ngjyrat në dispozicion  
E tejdokshme

## Veçoritë teknike

pH: 7.5 \_

Temperatura e vendosjes -30: +80 °C

## Mjetet e pastrimit

- Diluent Nitro

## Shtresat e lejuara

- Suva
- Beton
- Llaçe çimentoje, gëlqereje e të përziera
- Parafabrikua
- Gipse
- Fibroçimento
- Tulla
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me gurë
- Tulla dhe pllaka

## Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Shtresat (mbështetëse) duhet të jenë të pastra, pa njollosje, pjesë të shkatërruara dhe të paqëndrueshme, pluhur etj. Shkëputjet mes pllakave, nëse ka, duhet të trajtohen siç duhet me detergjentë të përshtatshëm acid ose alkaline. Në këtë drejtim, ne rekomandojmë detergjentin specifik DETERG-A, të holluar me ujë në raport 1: 4. Lani sipërfaqet e trajtuara me ujë të rrjedhshëm.

Shkëputjet e lëvizshme dhe jo konsistente, për t'u hequr, duhet domosdoshmërisht të restaurohen me stuko çimentoje me aderim të lartë dhe shformim. Për këtë, ne rekomandojmë përdorimin e STUCCO BALCONY me dy përbërës të papërshtatshëm nga uji dhe i shformuar. Prisni kohën e duhur (1-2 ditë) për tharjen e stukimit para aplikimit të PROTECH BALCONY. Çdo nyje zgjerimi e pranishme, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me vijën e bashkimit të dyshemeve me pllaka dhe bordurave perimetrale (zakonisht prej graniti ose guri natyror), do të duhet të mbyllin me materiale polimerike me elasticitet të larta. Për këtë, ju këshillojmë që t'i mbyllni me PROTECH FLEX, të ndihmuar nga hedhja e FILTENE FONDOGIUNTO dhe prajmerin e përshtatshëm poliuretanik PROTECH FLEX PRIMER.

## Mënyra e përdorimit

Derdhni sasi të vogla të produktit here pas here dhe përhapeni atë në mënyrë të barabartë në të gjithë sipërfaqen me një furçë prej gome ose një "shtrydhëse uji", deri në ngopjen e plotë të shtresës mbështetëse që do të hidroizolohet. Vendosni PROTECH BALCONY me shumë kujdes në zonat më të paarrtshme dhe më të prishura, duke përdorur një furçë me qime të gjata ose një sfungjer (cepat, bordet e skajshme, qoshet, pragjet, pusetat, oxhaqet, shkarkimet etj.). Lejeni produktin të depërtojë për të paktën 60 minuta..

Pas 120 minutave të aplikimit, hiqni produktin e tepërt në të gjitha sipërfaqet e trajtuara me një leckë të lagur me diluent Nitro.

Konsumi i produktit është mesatarisht rreth 0,14 / m<sup>2</sup> sipërfaqe që do të hidroizolohet; që ndryshon sipas përthithjes së shtresës mbështetëse dhe madhësisë së çdo shkëputje të mundshme. Zakonisht mendohet se me 1 litër PROTECH BALCONY ju mund të trajtoni një sipërfaqe nga 5 deri në 15 m<sup>2</sup>.



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: 25/08/2020  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

## Magazinimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarën dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Mbrojeni nga lagështia. Produkti duhet të ruhet në një temperaturë nga +5°C në +35°C.



## Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com). Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com).

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose ambalazhit të tij në mjedis.

Aplikojeni PROTECH BALCONY vetëm në sipërfaqe të thata. Mos i nisni veprimet hidroizoluese nëse parashikohen reshje atmosferike të afërta. Për më tepër, nuk është e këshillueshme aplikimi në prani të një ventilimi të theksuar meqenëse tretësi mund të avullojë shumë shpejt, duke kërkuar kështu një sasi më të madhe produkti dhe duke ia bërë më pak efikas ngjitjen e thellë të përbërësit aktiv.

Rekomandohet të mos nënvleftësohet faza përfundimtare e pastrimit sipërfaqësor të produktit të tepërt me diluent Nitro. Teprica të mundshme të produktit të pahequra në sipërfaqe, me të rënë në kontakt me ajrin, mund të shkaktojnë formimin e mbetjeve të padëshirueshme me ngjyrë të zbrëdhylët, që hiqet me vështirësi, të cilat gjithësesi mund të hiqen nëpërmjet një larje tjetër me detergjent acid.

Para kryerjes së çdo veprimi pastrimi me detergjent acid, është gjithësesi e domosdoshme të kryhen prova paraprake në një pjesë të vogël të dyshemesë (më mirë nëse nuk bie në sy), për të shmangur njolloshjen e pakëndshme të vetë dyshemesë.

Në rastin e aplikimit të ballkon PROTECH BALCONY në sipërfaqe veçanërisht poroze dhe absorbuese (tulla, gurë natyror, shtuf, etj), këshillohet që paraprakisht të përhapet produkti në një pjesë të vogël të dyshemesë. Shtresat mbajtëse shumë absorbuese, në fakt, mund të bëhen paksa më të errta për shkak të depërtimit të produktit.



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: 25/08/2020  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali  
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **25/08/2020**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)